

Deloitte.

Eco Tirana Sh.A.

**Raporti i Audituesit të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare të veçanta
më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

PASQYRAT FINANCIARE :

PASQYRA E VEÇANTË E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E VEÇANTË E PERFORMANCËS FINANCIARE	4
PASQYRA E VEÇANTË E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E VEÇANTË E FLUKSEVE TË MJETEVË MONETARE	6
SHËNIME SHPJEGUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE TË VEÇANTA	7-24

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtar Drejtimit të Eco Tirana sh.a.,

Opioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të veçanta Eco Tirana sh.a., (“Shoqëria”), të cilat përfshijnë pasqyrën e vecantë të pozicionit financier më 31 dhjetor 2017 dhe pasqyrën e vecantë të performancës financiare, pasqyrën e vecantë të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e vecantë të flukseve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe nga një përbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënimeve të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të veçanta bashkëlidhur paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financier të Shoqërisë më datë 31 dhjetor 2017 si edhe të performancës së saj financiare dhe flukset e monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (“SKK”).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombe të Auditimit (“SNA-të”). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshtuar në paragrafin e emërtuar “*Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare*” të këtij reporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombe të Etikës (“BKSNE”) dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, dhe të përdorë parimin e vijimësisë si bazë kontabile, përvèç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnë alternativë tjetër reale, përvèçse më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare. Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomali si pasojë e mashtrimit është më i lartë, se rreziku i moszbulimit të një anomali si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informaciont, përvetësimë të qëllimshme, keqinterpretimë, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmeri të atyre kontolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontolleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmérinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmérinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimive shpjeguese përkatëse të hartuara nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmérinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftesinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vemendjen në reportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidences së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Shoqërisë për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përbajtjen e pasqyrave financiare, duke përshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, pervecse cështjeve të tjera,,edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që është identifikur gjatë auditimit tonë.


Deloitte Audit Albania Sh.p.k.

Deloitte Audit Albania sh.p.k

Rr. Elbasanit, Pallati poshtë Fakultetit Gjeologji - Miniera,
Tiranë, Shqipëri

Numri i identifikimit unik të subjektit (NUIS): L41709002H

Enida Cara
Auditues Ligjor



Tiranë, Shqipëri
8 qershor 2018

Eco Tirana Sh.A.

Pasqyra e vecantë pozicionit finansiar per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë)

	Shënim	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
Aktivet			
Aktivet afatshkurtra			
Mjete monetare	4	5,033,641	31,245,758
Llogari të arkëtueshme	5	93,320,938	13,612,147
Llogari të tjera të arkëtueshme	6	13,580,348	52,933,547
Shpenzime të shtyra e të ardhura të llogaritura	7	3,633,431	6,502,463
Inventari	8	5,401,855	7,952,339
Totali i aktiveve afatshkurtra		120,970,213	112,246,254
Aktivet afatgjata			
Aktivet afatgjata materiale	9	274,274,298	266,129,730
Aktivet afatgjata financiare	10	41,198,264	-
Totali i aktiveve afatgjata		315,472,562	266,129,730
Totali i aktiveve		436,442,775	378,375,984
Detyrime dhe kapitali			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	11	6,688,454	-
Llogari të pagueshme tregtare	13	77,817,649	304,763,891
Detyrime tatumore	14	9,309,521	1,610,966
Detyrime të tjera afatshkurtra	15	5,203,891	2,817,296
Totali i detyrimeve afatshkurtra		99,019,515	309,192,153
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	12	320,097,900	69,967,299
Totali i detyrimeve afatgjata		320,097,900	69,967,299
Totali i detyrimeve		419,117,415	379,159,452
Kapitali aksionar			
Kapitali aksionar	16	3,900,000	3,900,000
Humbja e akumuluara		(4,683,468)	-
Fitimi / (Humbja) e vitit		18,108,828	(4,683,468)
Totali i kapitalit aksionar qe i takon		17,325,160	(783,468)
Eco Tirana Sh.A.			
Interesa jo kontrollues		-	-
Totali i kapitalit aksionar		17,325,360	(783,468)
Totali i detyrimeve dhe i kapitalit		436,442,775	378,375,984

Pasqyra e vecante e pozicionit finansiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare te veçanta janë miratuar nga Këshilli Mbikqyrës më 7 qershor 2018 dhe janë nënshkruar nga:

Diego Testi

Administrator

MB CONSULTING SH.P.K.

Hartues i pasqyrave financiare



Eco Tirana Sh.A.

Pasqyra e vecantë e performancës financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë)

	Shënim	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017	Për periudhën nga data 8 korrik 2016 deri më 31 dhjetor 2016
Shitjet neto	17	328,066,817	11,257,810
Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	18	7,793,353	141,387
Totali i të ardhurave		335,860,169	11,399,387
Materialet e konsumuara	19	(58,563,177)	(705,307)
Kosto e punës	20	(124,847,178)	(8,793,886)
Amortizimet	9	(58,042,204)	(1,863,542)
Shpenzime të tjera	21	(59,047,778)	(4,446,234)
Totali i shpenzimeve		(300,500,337)	(15,808,969)
Fitimi / (Humbja) nga veprimtaria kryesore		35,359,832	(4,409,772)
Të ardhura dhe shpenzime financiare			
Fitim nga kursi i këmbimit		5,116,929	50,153
Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi	22	(16,561,551)	(323,849)
Totali shpenzimeve financiare neto		(11,444,621)	(273,696)
Fitim/(Humbja) para tatimit		23,915,211	(4,683,468)
Tatimi mbi fitimin	23	(5,806,383)	-
Fitimi / (Humbja) neto për periudhën		18,108,828	(4,683,468)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për periudhën		-	-
Totali i të ardhurave/(humbjeve) gjithëpërfshirëse për periudhën		18,108,828	(4,683,468)

Pasqyra e vecante e performances financiare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Eco Tirana Sh.A.

Pasqyra e vecantë e ndryshimeve ne kapitalin neto per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë)

	Kapitali akcionar	Humbje të mbartura	Totali
Gjendja më 8 korrik 2016 (data e krijimit)			
Emetim i kapitalit akzionar	3,900,000	-	3,900,000
Humbja e periudhës	-	(4,683,468)	(4,683,468)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	3,900,000	(4,683,468)	(783,468)
Emetim i kapitalit akzionar	-	-	-
Fitimi i vittit		18,108,828	18,108,828
Gjendja më 31 dhjetor 2017	3,900,000	13,425,360	17,325,360

Pasqyra e vecante e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpëreguese nga faqja 7 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë)

		Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017	Për periudhën nga data 8 korrik 2016 deri më 31 dhjetor 2016
Flukset e mjeteve monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit			
Fitim/(humbja) para tatimit		23,915,211	(4,683,468)
Rregullimet për:			
Amortizim dhe zhvlerësim	9	58,042,204	3,003,849
Nxjerra jaشتë përdorirnit e aktiveve afatgjata materiale		2,632,474	-
Zhvleresim i inventarit		1,190,831	-
Shpenzime per interesa (neto)	22	16,561,551	323,849
Ndryshimet në kapitalin punues			
Rritje në llogaritë arkëtueshme dhe të tjera		(38,174,823)	(73,048,157)
Renie/(Rritje) në inventarët		1,359,653	(7,952,339)
Renie/(Rritje) në llogarite e pagueshme dhe te tjera		(219,044,296)	309,192,153
Mjete monetare (përdorur në)/gjeneruar nga veprimtaritë e shfrytëzimit		(153,517,196)	226,835,887
Tatim fitimi i paguar		(3,000,000)	-
Interes i paguar		(13,166,928)	-
Mjete monetare (përdorur në)/e gjeneruar nga veprimtaritë e shfrytëzimit		(169,684,124)	226,835,887
Mjete monetare nga veprimtaritë investuese			
Para të përdorura për blerjen e filialeve		(510,000)	-
Pagesa për blerjen e investimeve të tjera		(40,000,000)	-
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	9	(68,819,246)	(269,133,579)
Mjete monetare përdorur në veprimtaritë investuese		(109,329,246)	(269,133,579)
Flukset e mjeteve monetare nga veprimtaritë financuese			
Hyrje nga emetimi i kapitalit aksionar		-	3,900,000
Hyrje nga huat		269,728,754	69,643,450
Pagesa të huave		(16,927,500)	
Blerje e interesave jo kontrollues			
Mjete monetare gjeneruar nga veprimtaritë financuese		252,801,254	73,543,450
Rritja neto e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre		(26,212,116)	31,245,758
Mjetet monetare dhe ekuvalente të tyre në fillim të vitit	4	31,245,758	-
Mjetet monetare dhe ekuvalente të tyre në fund të vitit	4	5,033,641	31,245,758

Pasqyra e vecantë e Flukseve të Mjeteve Monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Eco Tirana Sh.a. është dhe një Shoqëri aksionare shqiptare dhe është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më 8 korrik 2016 me numër identifikimi NUIS L61908027S.

Kapitali i nenshkruar i Shoqerise eshte 3,900,000 Lek me 31 dhjetor 2017 dhe eshte 51% ne pronesi te Bashkia Tirane dhe 49% ne pronesi te ASGM Holding Albania.

Shoqeria ka një sistem administrimi me 2 nivele, përkatësish Keshilli i Administratoreve dhe Keshilli Mbikqyres, qe zgjidhen nga Asambleja e Pergjithshme. Kryetar i Keshillit te Administratoreve dhe Administratori Ekzekutiv i Shoqerise eshte z. Diego Testi, dhe Kryetar i Keshillit Mbikqyres eshte z. Taulant Tusha.

Aktiviteti kryesor i Eco Tirana Sh.A. është manaxhimi i shërbimeve mjedisore, duke përfshirë mbledhjen, transportin, ndërmjetësimin dhe tregtimin e mbetjeve dhe të materialeve që rrjedhin prej tyre, duke përfshirë edhe grumbullimin e diferencuar të tyre, si dhe pastrimin e hapësirave publike, ndërtimin dhe menaxhimin, edhe për llogari të palëve të treta, të impianteve për rikuperimin, riciklimin, trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve, rehabilitimin e zonave nga substancat ndotëse,etj.

Shoqeria operon ne baze te një kontrate shërbimi te nënshkruar me Bashkine Tirane, e cila i jep te drejtën eksluzive te Sherbimeve te Pastrimit, fillimisht te një zone te caktuar, dhe me tej te gjithë territorit te administruar nga Bashkia Tirane. Kjo kontrate ka një kohëzgjatje jo me pak se 25 vjet duke filluar nga data efektive e shërbimit.

Me 20 korrik 2017 Shoqeria ne bashkëpunim me Shoqërinë Meg Albania Shpk krijuan një Shoqëri te re te emërtuar Eco Recycling Shpk, me kapital te nënshkruar 1,000,000 Lek ku Eco Tirana ka 51% te pronësisë me 31 dhjetor 2017. Objekti i aktivitetit te shoqërisë Eco Recycling Shpk lidhet kryesisht me përpunimin, tregtimin, mbledhjen, transportimin, magazinimin, trajtimin dhe seleksionimin e mbetjeve te te gjitha llojeve, etj.

Selia e regjistruar e Shoqërisë është në adresën rruga Murat Toptani, Gjergji Center, kat 7.

Me 31 dhjetor 2017 Shoqeria Eco Tirana Sh.A. ka 290 punonjes (31 dhjetor 2016: 171).

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

2. BAZA E PËRGATITJES

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare te veçanta të Shoqerise jane pergatitur, ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit (“SKK”).

Shoqëria gjithashtu ka përgatitur pasqyrat financiare të konsoliduara në përputhje me SKK-të për Shoqërinë dhe degët e saj ('grupi). Në pasqyrat financiare të konsoliduara, sipërmarrjet filiale – të cilat janë ato shoqëri në të cilat Grupi, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë, ka influencë mbi gjysmën e të drejtave të votës ose ndryshe ka fuqinë të ushtrojë kontroll mbi aktivitetet – janë konsoliduar plotësisht. Përdoruesit e këtyre pasqyrave të veçanta duhet ti lexojnë ato së bashku me pasqyrat e konsoliduara të grüpuit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 në mënyrë që të marrin informacion të plotë mbi pozicionin financier, rezultatin e operacioneve dhe ndryshimet në pozicionin financier të grüpuit në tërsi.

2.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare të veçanta janë përgatitur bazuar në koston historike, përveç rasteve nëse specifikohet ndryshe.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Pasqyrat financiare të veçanta janë pasqyruar në Lekë e cila është moneda funksionale dhe raportuese e Shoqërisë. Shifrat janë te rrumbullakosura në Lekë.

2.4 Përdorimi i gjykimeve dhe vlerësimeve

Paraqitura e pasqyrave financiare të veçanta në përputhje me SKK, kërkon që manaxhimi të bëjë vlerësim, gjykime e supozime që ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe vlerën e raportuar të aktiveve, detyrimeve, te ardhurave e shpenzimeve. Vlerësimet dhe supozimet bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë të ndryshëm në varësi të rrethanave. Rezultatet aktuale mund te ndryshojnë nga këto vlerësimet.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen vazhdimisht. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën kur ndodh rishikimi si dhe ne çdo periudhe te ardhme që preket.

Në veçanti, informacionet mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare.

2.5 Periudhat krahasuese

Të dhënat e periudhave të mëparshme mund të ri klasifikohen për t'i bërë ato të krahasueshme me paraqitjen e të dhënave të periudhës ushtrimore.

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL

Politikat kontabël ne vijim janë aplikuar ne mënyre te qëndrueshme ne te gjitha periudhat e paraqitura ne pasqyrat financiare, me përashtim te rasteve kur specifikohet ndryshe nëse ka te tilla.

3.1 Transaksionet në monedha të huaja

Transaksionet ne monedhe te huaj regjistrohen ne monedhën funksionale me kursin e këmbimit ne datën e transaksionit. Mjetet monetare ne monedhe te huaj rivlerësohen ne fund te çdo periudhe raportuese me kursin zyrtar te këmbimit ne datën e raportimit.

Mjetet jo-monetare ne monedhe te huaj regjistrohen ne monedhën funksionale me kursin e këmbimit te datës se kryerjes se transaksionit, ndërsa mjetet jo-monetare qe maten me vlere te drejte rivlerësohen ne monedhën funksionale me kursin e këmbimit ne datën kur përcaktohet vlera e drejte.

Fitimi ose humbja qe rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë ne pasqyrën e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit te përdorura për konvertim ne 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë si me poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
EURO	132.95	135.23

3.2 Instrumentet financiare

Instrumentet financiare jo-derivative përbehen nga llogari te arkëtueshme, mjete monetare, hua te marra dhe te dhëna dhe llogari te pagueshme. Instrumentet financiare jo-derivative njihen fillimisht me vlerën e drejte plus çdo kosto transaksioni qe lidhet me to, përvèç sic përshkruhet me poshtë. Për instrumentet e mbajtur me vlere te drejte nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë ne pasqyrën e te ardhurave dhe shpenzimeve. Ne vijim te njohjes fillestare instrumentet financiare jo-derivative maten sic përshkruhet me poshtë. Një instrument finanziar njihet nëse Shoqëria behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit.

Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë te drejtat kontraktuale te shoqërisë mbi flukset e parasë se aktivit finanziar ose kur shoqëria transferon aktivin financier tek një pale e trete pa mbajtur kontrollin ose gjithë rreziqet dhe përfitimet thelbësore te aktivit. Blerjet dhe shitjet normale te aktiveve financiare kontabilizohen ne datën e transaksionit, qe është data ne te cilën shoqëria angazhohet te blejë apo te shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale te shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare dhe te tjera ekuivalente

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogarite rrjedhëse, si dhe depozitat afatshkurtra me një maturitet deri ne tre muaj.

Llogarite e arkëtueshme

Llogarite e arkëtueshme dhe llogarite e tjera te arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejte dhe me pas me kosto te amortizuar duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi. Provigioni për zhvlerësimin e aktiveve te arkëtueshme llogaritet kur ka te dhëna se shoqëria nuk do te jete ne gjendje te mbledhë te gjitha detyrimet. Vështirësítë financiare te debitorit, mundësia qe debitori te falimentoje ose riorganizimi i tij financier konsiderohen tregues qe llogarite e arkëtueshme te zhvlerësohen.

Shuma e provigionit llogaritet si diferenca midis vlerës se mbetur dhe vlerës aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parasë te skontuara me normën efektive te interesit.

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

3.2 Instrumentet financiare (vazhdim)

Llogarite e pagueshme

Llogarite e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre te drejte dhe ne vijim maten me kosto te amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Huamarrjet dhe parapagimet

Huat e marra nga Institucionet Financiare njihen fillimisht me vlerën e drejte, duke zbritur koston e transaksionit. Detyrimet financiare maten me pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke njojur shpenzimin e interesit mbi bazën e interesit efektiv.

Metoda e normës efektive te interesit është një metode për llogaritjen e kostos se amortizuar te një detyrimi financier dhe për alokimin e shpenzimeve te interesit përgjatë periudhës. Norma efektive e interesit është norma e cila skonton saktësisht pagesat e ardhshme te vlerësuara përgjatë jetës se pritshme te detyrimit financier, ose, ku është e përshtatshme, për një periudhe me te shkurtër.

Te tjera

Instrumente te tjera financiare jo derivative janë matur me koston e amortizueseje, duke përdorur metodën e normës se interesit efektiv, duke zbritur humbjet nga zhvlerësimet.

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme janë klasifikuar si kapital.

3.3 Aktivet afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Aktivet afatgjata materiale maten me kosto, duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga zhvlerësimi.

Kostoja përfshin shpenzimet te cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve te ndërtuara nga vete shoqëria përfshin koston e materialeve dhe punës direket dhe çdo kosto tjetër te lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit ne gjendje pune për qëllimin e synuar te përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes se pjesëve dhe sjelljes ne gjendjen e mëparshme te vendndodhjes se aktivit. Shpenzimet kapitale te bëra gjate ndërtimit kapitalizohen ne "Ndërtim ne proces" dhe transferohen ne kategorinë përkatëse te aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Ne rastet kur pjesë te një aktivi afatgjate material kane jetëgjatësi te ndryshme, ato regjistrohen si zëra te ndryshëm te ndara nga njëra tjetra.

Fitimet ose humbjet nga shitjet apo nxjerijet jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata materiale përcaktohen duke krahasuar te ardhurën nga shitja me vlerën kontabël neto te aktivit afatgjate material mbetur dhe njihen ne te ardhura ose humbje te tjera.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

3.3 Aktivet afatgjata materiale (vazhdim)

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën lineare apo zbritëse të amortizimit, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira financiare amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen. Metodat dhe normat e amortizimit për periudhën aktuale dhe te mëparshme janë si me poshtë:

Ndërtesa	5% (mbi vlerën e mbetur)
Makineri dhe pajisje	20% (mbi vlerën e mbetur)
Mjete transporti	20% (mbi vlerën e mbetur)
Pajisje kompjuterike	25% (mbi vlerën e mbetur)
Pajisje zyre dhe te tjera	20% (mbi vlerën e mbetur)

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.4 Inventarët

Inventarët maten fillimisht me kostot. Kostoja e inventarit përfshin, përvèç çmimit të blerjes, edhe të gjitha kostot e tjera që nevojiten për të sjellë inventarin në gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese.

Pas njohjes fillestare inventarët vlerësohen me vlerën më të vogël ndermjet kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja e inventarit përcaktohet sipas metodës se mesatares se ponderuar. Vlera neto e realizueshme është çmimi i shitjes i vlerësuar në rrjedhën normale të biznesit, minus kostot e vlerësuara të nevojshme për të kryer shitjen, sipas metodës se kostos mesatare te ponderuar.

3.5 Zhvlerësimi

i. Aktivet financiare

Një aktiv finanziar që nuk mbahet me vlerën e drejtë, vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë te dhëne që ka pësuar rënienë në vlerë. Një aktiv finanziar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivit dhe të cilat mund të maten me besueshmëri.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin finanziar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të aktualizuara me normën efektive të interesit. Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë, ndërsa aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Aktivet jo financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo financiare te shoqërisë rishikohet ne çdo date raportimi për te përcaktuar nëse ka ndonjë te dhëne qe ka pësuar rënienë ne vlere. Nëse ka te dhëna te tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Vlera e rikuperueshme është vlera më e madhe midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivit tejkalon vlerën e tij te rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen ne pasqyrën e te ardhurave dhe shpenzimeve.

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZDHIM)

3.6 Përfitimet e punonjësve

Gjatë ecurisë normale të aktivitetit te saj, shoqëria paguan kontributet shoqërore dhe shëndetësore ne emër te vet dhe te punonjësve te saj, të cilat janë të detyrueshme sipas legjislacionit Shqiptar ne fuqi. Këto kosto të kryera në emër të shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën përbledhëse të të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin e ndodhjes.

3.7 Provojonet

Një provojon njihet kur, si pasojë e ngjarjeve të kaluara, shoqëria ka detyrime aktuale ligjore apo konstruktive të cilat mund të vlerësohen ne mënyre te besueshme, dhe është e mundur që të nevojiten flukse dalëse të burimeve ekonomike për të shlyer këto detyrime. Provojonet përcaktohen nga aktualizimi i flukseve të pritshme me një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të parasë dhe rrezikut specifik të detyrimeve.

3.8 Njohja e te ardhurave

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që shoqëria do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të arkëtar ose të arkëtueshme, duke marre parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, për shlyerje të menjëhershme etj.

Te ardhurat dhe shpenzimet njihen ne pasqyrat financiare te periudhës te cilës i përkasin. Ne lidhje me shitjen e mallrave, te ardhurat njihen kur ndryshimi i pronësisë se bashku me rrezikun qe vjen nga ky ndryshim, janë transferuar tek blerësi. Te ardhurat nga shërbimet njihen kur shërbimi është kryer, ne varësi te fazës së përfundimit te transaksionit ne datën e raportimit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri te larte lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3.9 Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat financiare përfshijnë te ardhurat nga interesat për llogarite bankare, dhe përfitimet nga diferencat e këmbimit. Interesat njihen ashtu siç përllogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet për interesa dhe humbjet nga luhatjet e kurseve te këmbimit, ndryshimet ne vlerën e drejtë te aktiveve financiare te mbajtura me vlere te drejtë nëpërmjet pasqyrës se te ardhurave dhe shpenzimeve, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare.

Kostot e huamarrjes njihen ne pasqyrën e te ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv. Fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit raportohen ne baza neto.

3.10 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës, i cili njihet drejtpërdrejt ne pasqyrën e te ardhurave dhe shpenzimeve. Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi te ardhurat e tatushme te vitit, duke përdorur normat tatimore te miratuara ne periudhën e raportimit.

3.11 Ngjarjet pas datës së bilancit

Ngjarjet pas datës së raportimit, të cilat ofrojnë dëshmi për kushtet që ekzistojnë në datën e raportimit, trajtohen si ngjarje të korrigueshme në këto pasqyra financiare. Ata që janë tregues të kushteve që lindin pas datës së raportimit janë trajtuar si ngjarje të pakorrigueshme.

Eco Tirana Sh.A.

Shenime shpjeguese të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

4. MJETET MONETARE DHE EKUIVALENTE TE TYRE

Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen nga sa më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në bankë	4,972,667	31,112,163
- në Lekë	4,779,276	1,019,030
- në monedhë të huaj	193,392	30,093,132
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në arkë	60,974	133,595
- në Lekë	60,974	133,595
Totali	5,033,641	31,245,758

5. LLOGARI TË ARKËTUESHME

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen nga sa më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
Bashkia Tirane	92,453,511	12,714,219
Klientë të tjera	867,428	897,927
Totali	93,320,938	13,612,147

Zëri klientë te tjera ne pasqyrat financiare tpërfshin kryesisht detyrimet e klientëve nga kontratat e qirasë.

6. LLOGARI TË TJERA TË ARKËTUESHME

Llogari të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen nga sa më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH)	13,552,808	52,917,415
Kreditore të tjera	27,540	16,133
Totali	13,580,348	52,933,548

TVSH e arketueshme lidhet me blerjet e makinave te pastrimit nga Eco Tirana.

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

7. SHPENZIME TË SHTYRA DHE TË ARDHURA TË LLOGARITURA

Shpenzime të shtyra dhe të ardhura të llogaritura më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen nga sa më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
Shpenzime të periudhave të ardhshme për sigurime	1,506,714	5,430,278
Shpenzime të periudhave të ardhshme të tjera	1,186,534	1,043,835
Të ardhura të llogaritura	940,183	28,350
Totali	3,633,431	6,502,463

8. INVENTARI

Inventari më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhet nga sa më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
Materiale shërbimi	2,536,302	119,287
Materiele mirëmbajtje-pastrimi	2,089,780	162,173
Materiale pune për punonjësit	577,882	212,154
Materiale promocionale	78,500	2,688,400
Karburant	51,250	434,153
Inventar i imët	49,422	1,300,892
Materiale të tjera të konsumueshme	18,719	126,539
Materiale kanceleri dhe zyrë	-	17,910
Nënprodukte dhe produkte mbeturine	-	2,890,831
Totali	5,401,855	7,952,339

Eco Tirana nuk registroi nënprodukte dhe produkte mbeturine gjate vitit 2017. Vetëm me krijimin e Shoqërisë se re Eco Recycling, te gjitha produktet mbeturine i kaluan nën administrim Eco Recycling për ti përpunuar/seleksionuar në impiantin e Sharrës.

Inventari i mbledhur gjate vitit 2016, ju shit/trasferua Shoqërisë Eco Recycling.

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

9. AKTIVE AFATAGJATA MATERIALE

Aktivet afatgjata materiale më 31 dhjetor 2017 janë të përbëra si më poshtë:

	Ndërtime	Instalime teknike, makineri	Pajisje e vegla pune	Transporti	Mjetet	Mobilje dhe Pajisje Zyre	Pajisje Informatike	Totali
<i>Kosto</i>								
Gjendje më 31 dhjetor 2016	1,492,583	28,550,000	12,767,773	225,067,860		620,363	635,000	269,128,579
Shtesa	8,351,971	30,327,211 (2,969,200)	58,300 (83,318)	29,259,416		387,000	435,348	68,819,246
Pakësime	-			-		-	-	(3,052,518)
Gjendje më 31 dhjetor 2017	9,844,554	55,908,011	12,742,755	254,327,276		1,007,363	1,070,348	334,900,307
<i>Amortizim i akumuluar</i>								
Gjendje më 31 dhjetor 2016	-	-	-	2,990,523		97	13,229	3,003,849
Shtesa	74,629	9,896,760 (415,878)	2,546,887 (4,166)	45,187,757		124,053	212,118	58,042,204
Pakësime	-			-		-	-	(420,044)
Gjendje më 31 dhjetor 2017	74,629	9,480,882	2,542,721	48,178,280		124,150	225,347	60,626,009
<i>Vlera e mbetur neto</i>								
Gjendje më 31 dhjetor 2016	1,492,583	28,550,000	12,767,773	222,077,337		620,266	621,771	266,129,730
Gjendje më 31 dhjetor 2017	9,769,925	46,427,129	10,200,034	206,148,997		883,213	845,001	274,274,298

Gjate vitit 2017 shtesat/blerjet kryesore në aktive afatgjata materiale perbehën nga kamionët, makineritë e pastrimit, dhe kazanët e grumbullimit të mbetjeve. Gjithashtu, Shoqeria Eco Tirana ka kryer edhe punime ndërtimi përi rikonstrukcionin e ambjenteve të vendqëndrimit të mjeteve në Don Bosko.

Mjetet e transportit/pastrimit pronë e Shoqerisë Eco Tirana rezultojnë të vendosura si kolateral/garanci për huane e marië nga AGSM Holding Albania Sh.a.

Eco Tirana Sh.A.

Shenime shpjeguese të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

10. AKTIVE AFATGJATA FINANCIARE

Aktivet afatgjata financiare më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen nga sa më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
Investimi ne Eco Recycling Shpk	510,000	-
Hua afatgjate per Eco Recycling Shpk	40,000,000	-
Interesa aktive të llogaritura	688,264	-
Totali	41,198,264	-

Me 20 korrik 2017 Shoqeria ne bashkëpunim me shoqërinë Meg Albania Shpk krijuan një shoqëri te re te emërtuar Eco Recycling Shpk, me kapital te nënshkruar 1,000,000 Lek ku Eco Tirana ka 51% te pronësisë me 31 dhjetor 2017. Pjesa tjetër prej 49% te pronësisë me 31 dhjetor 2017 mbahet nga Meg Albania Sh.p.k. Objekti i aktivitetit te shoqërisë Eco Recycling Shpk lidhet kryesisht me përpunimin, tregtimin, mbledhjen, transportimin, magazinimin, trajtimin dhe seleksionimin e mbetjeve te te gjitha llojeve, etj.

Më 24 gusht 2017, Eco Tirana Sh.A. nënshkroi një kontratë financimi me Eco Recycling për një total prej 47,940,000 Lek. Deri më 31 dhjetor 2017 është disbursuar shuma prej 40,000,000 Lek. Huaja ka një norme interesи vjetore prej 5.5% dhe një kohëzgjatje prej 60 muajsh. Kontrata parashikon ripagimin e huas me këste të barabarta çdo 3-muaj duke filluar nga muaji Janar 2018. Si garanci për këtë hua është vendosur linja e seleksionimit të mbetjeve dhe gjithë pajisjeve ndihmëse, në pronësi të Eco Recycling.

11. HUA AFATSHKURTRA

	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
Overdraft - Banka Intesa San Paolo	6,688,454	-
Totali	6,688,454	-

Shoqeria ka nënshkruar një kontratë financimi me kufi (overdrafti) me Intesa San Paolo me një limit përdorimi prej 30,000,000 Lek dhe me kohëzgjatje 1-vjecare.

Eco Tirana Sh.A.**Shenime shpjeguese të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017***(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)***12. HUA AFATGJATA**

Huatë afatgjata më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen nga sa më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
Hua nga ASGM Holding Albania Sh.a.	315,756,250	69,643,450
Interesa pasive të llogaritura	4,341,650	323,849
Totali	<u>320,097,900</u>	<u>69,967,299</u>

Gjatë vitit 2016 Shoqëria Eco Tirana u financua me hua nga ASGM Holding Albania Sh.A. në vlerën 2,500,000 Euro për blerjen e mjeteve te transportit dhe pastrimit. E gjithë vlera e financimit është disbursuar në dhjetor 2016 dhe janar 2017. Principali i pagueshëm me 31 dhjetor 2017 eshte 2,375,000 Eur (315,756,250 Leke). Huaja ka një normë interesë 5.5% dhe afat maturimi 60 muaj.

13. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE

Llogari të pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen nga sa më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
Llogari të pagueshme ndaj furnitorëve	73,717,746	304,763,891
Llogari të pagueshme ndaj palëve te lidhura	4,099,903	-
Totali	<u>77,817,649</u>	<u>304,763,891</u>

Llogari te pagueshme ndaj furnitorëve pale te treta me 31 dhjetor 2017 dhe 2016 perbehën kryesisht nga vlerat e pagueshme per blerjen e kamionëve dhe makinave te pastrimit.

14. DETYRIME TATIMORE

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen nga sa më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
Sigurime dhe tatim mbi të ardhurat personale	6,194,182	1,394,150
Tatimi mbi fitimin	2,806,383	-
Tatimi në burim	-	216,816
Të tjera	308,956	-
Totali	<u>9,309,521</u>	<u>1,610,966</u>

Eco Tirana Sh.A.

Shenime shpjeguese të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

15. DETYRIME TË TJERA AFATSHKURTRA

Detyrime të tjera afatshkurtra më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen nga sa më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
Shpenzime te perllogaritura	3,562,913	2,582,287
Paga dhe shpërblime	1,121,141	235,009
Te tjera	519,837	-
Totali	<u>5,203,891</u>	<u>2,817,296</u>

Shpenzimet e përllogaritura përbëhen kryesisht nga konsumi i karburantit për muajin dhjetor, e faturuar ne janar 2018.

16. KAPITALI AKSIONAR

Kapitali i nënshkruar i Shoqërisë është 3,900,000 Lekë. Struktura a aksionareve është si me poshtë:

	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
Bashkia Tiranë	51%	51%
AGSM Holding Albania	49%	49%
Totali	<u>3,900,000</u>	<u>3,900,000</u>

17. SHITJE NETO

	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017	Për periudhën nga data 8 korrik 2016 deri më 31 dhjetor 2016
Te ardhura nga mbledhja e mbeturinave dhe pastrimi	325,950,349	11,257,810
Shitje e produkteve mbeturine	1,700,000	-
Shitje e produkteve te gatshme pas seleksionimit	-	-
Te tjera	416,468	-
Totali	<u>328,066,817</u>	<u>11,257,810</u>

Te ardhurat nga mbledhja e mbeturinave dhe pastrimi nga Bashkia Tiranë ne lidhje me shërbimet e kryera gjate vitit 2017 ne territorin e përcaktuar ne kontratën midis palëve.

Ne vitin 2017, Eco Tirana nuk ka gjeneruar te ardhura nga shitja e produkteve mbeturine. Deri ne krijimin e Shoqërisë Eco Recycling mbeturinat e mbledhura janë depozituar ne impiantin ose landfillin e Sharres. Me tej mbeturinat e diferencaura te mbledhura jane shkarkuar pranë impiantit te Shoqërisë Eco Recycling për përgjedhjen dhe seleksionimin e pjesës ekonomikisht te shfrytëzueshme dhe destinimin per asnjësim pranë landfillit te Sharres te pjesës "mbeturine".

*(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)***18. TË ARDHURA TË TJERA NGA VEPRIMTARITË E SHFRYTËZIMIT**

Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017	Për periudhën nga data 8 korrik 2016 deri më 31 dhjetor 2016
Kapitalizimi i kostove te punes per punime te brendshme ndertimi	2,507,805
Demshperblime nga sigurimet	2,121,787
Penalitete te marra nga furnitoret	2,182,400
Te ardhura nga qiratë	681,702
Te ardhura te tjera	299,658
Totali	7,793,353
	141,387

Kosto e kapitalizuara per punime te brendshme i referohen kostos se personelit te shoqërisë Eco Tirana per rikonstrukzionin e ambjenteve ne Don Bosko, qe aktualisht shërbejne si vendqëndrim i mjeteve dhe magazine per Shoqërinë.

Demshperblime nga sigurimet perbehet nga dëmshpérblimet per kazanët e dëmtuar apo te djegur si edhe dëmshpérblimet nga sigurimi i automjeteve te Shoqërisë Eco Tirana.

Penalite te marra nga furnitorët i referohet penaliteve te aplikuara ndaj furnitorëve në rast te moszbatimit te afatit te dorëzimit te porosisë, sipas kushteve kontraktuale.

19. MATERIALE TE KONSUMUARA

Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017	Për periudhën nga data 8 korrik 2016 deri më 31 dhjetor 2016
Karburant	33,621,151
Materiale sherbimi, mirembajtje dhe per punonjesit	13,050,380
Nenkontrakte te sherbimeve	7,725,590
Materiale te tjera te konsumueshme	1,941,740
Nënprodukte dhe produkte mbeturine	1,700,000
Utilitete	524,316
Totali	58,563,177
	705,307

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

20. KOSTO E PUNËS

Kosto e punës përbehen nga pagat bruto dhe kostot e sigurimeve shoqërore qe paguan shoqëria si me poshtë:

	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017	Për periudhën nga data 8 korrik 2016 deri më 31 dhjetor 2016
Shpenzime për paga	107,010,226	7,683,588
Kontributet	17,836,952	1,110,298
Totali	124,847,178	8,793,886

21. SHPENZIME TË TJERA

Shpenzime të tjera përfshijnë zërat e mëposhtëm:

	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017	Për periudhën nga data 8 korrik 2016 deri më 31 dhjetor 2016
Publicitet dhe komunikim	14,613,859	304,600
Qira	10,358,096	1,338,777
Sigurime	8,542,399	337,095
Sherbime mirembajtje	7,912,216	-
Shërbime profesionale	5,267,438	538,499
Shërbime sigurie	3,127,144	246,294
Shpërblimet e këshillit mbikëqyrës	2,848,824	1,427,753
Nxjerrje nga perdorimi i aktiveve afatgjata materiale	2,632,474	-
Të tjera	1,554,720	128,913
Zhvleresimi i inventarit	1,190,831	-
Shpenzime telekomunikacioni	670,084	-
Kancelari	276,288	72,804
Shërbime transporti	53,405	51,500
Totali	59,047,778	4,446,234

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

22. TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET NGA INTERESI

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi deri më 31 dhjetor 2017 përbëhen nga zërat e mëposhtëm:

	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017	Për periudhën nga data 8 korrik 2016 deri më 31 dhjetor 2016
Te ardhura interesi - palë te lidhura	688,264	-
Shpenzime interesi - palë te lidhura	(17,170,360)	(323,849)
Shpenzime interesi - Overdraft bankar	(79,454)	-
Totali	16,561,551	(323,849)

23. SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin më 31 dhjetor 2017 përbëhen nga sa më poshtë:

	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017	Për periudhën nga data 8 korrik 2016 deri më 31 dhjetor 2016
Fitimi/(Humbja) para tatimit	23,915,211	(4,683,468)
Shpenzime te pazbritshme	19,381,063	96,416)
Humbje e mbartur	(4,587,052)	-
Fitimi (humbja) e tatueshme	38,709,222	(4,587,052)
Përqindja e tatimit mbi fitimin	15%	15%
Tatimi mbi fitimin	(5,806,383)	-

Bazuar ne legjislacionin Shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin është 15% për vitin 2017 (15%: 2016).

Deklaratat tatimore të tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoritetet tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara konsiderohen vetë-deklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë regjistrimet dhe deklaratat e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final.

Legjislacioni tatimor dhe ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Eco Tirana Sh.A.

Shenime shpjeguese të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

24. PALËT E LIDHURA

Një numër transaksionesh mund te kryhen me palët e lidhura në rrjedhën normale të biznesit. Këto transaksione janë kryer në terma tregtare dhe në normat e tregut.

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2017	Për periudhën nga data 8 korrik 2016 deri më 31 dhjetor 2016
Llogari te arkëtueshme		
Bashkia Tirane	92,953,272	12,714,219
Eco Recycling	499,762	-
Total llogari te arkëtueshme	92,953,272	12,714,219
Te ardhura te llogaritura		
Eco Recycling	688,264	-
Total te ardhura te llogaritura	688,264	-
Aktive afatgjata financiare		
Eco Recycling	40,000,000	-
Total aktive afatgjata financiare	40,000,000	-
Llogari te pagueshme		
Bashkia Tirane	43,299	-
Eco Recycling	2,970,420	-
AGSM Holding Albania	1,086,184	-
Total llogari te pagueshme	4,099,903	-
Llogari te tjera te pagueshme		
AGSM Holding Albania	4,341,650	323,849
Total llogari te pagueshme	4,341,650	323,849
Hua Afatgjata		
AGSM Holding Albania	315,756,250	69,643,450
Total Hua afatgjata	315,756,250	69,643,450
Shitje neto		
Bashkia Tirane	325,695,988	10,595,183
Eco Recycling	2,116,468	-
Total shitje neto	327,812,456	10,595,183
Shpenzime		
Bashkia Tirane	819,323	-
Eco Recycling	4,127,390	-
AGSM Holding Albania	5,311,680	-
Total Shpenzime	10,258,393	-
Te ardhura (shpenzime) nga interesi		
Eco Recycling	688,264	-
AGSM Holding Albania	(17,249,814)	(323,849)
Total te ardhura (shpenzime) nga interesi	(16,561,551)	(323,849)

**Për periudhën nga data
8 korrik 2016 deri më
31 dhjetor 2016**

**Per vitin e mbyllur
me 31 dhjetor 2017**

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

24. PALËT E LIDHURA (VAZHDIM)

	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017	Për periudhën nga data 8 korrik 2016 deri më 31 dhjetor 2016
Shpërblimi i këshillit mbikqyres	2,848,824	1,427,753
TOTALI	2,848,824	1,427,753

25. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

Shoqeria eshte e eksposuar ndaj rreziqeve te meposhtme:

a) Rreziku i normes se interesit

Risku i normave te interesit perben riskun e luhatjeve te vlerave te instrumentave financiare si pasoje e ndryshimeve ne tregun e normave te interesit dhe risku qe maturitetet e interesave, ne lidhje me aktivet ndryshon nga maturiteti i interesave te lidhura me detyrimet e perdorura per keto aktive. Kohezgjatja per te cilen eshte fiksuar norma e interesit mbi një instrument finanziar tregon se ndaj çfare niveli risku te normave te interesit eshte eksposuar Shoqeria. Aktivet dhe pasivet e Shoqerise kane norma interesit te tregut.

b) Rreziku i kredise

Shoqeria nuk eshte e eksposuar ndaj rrezikut te kreditit, qe do te ndikonte ne poziten dhe performancen e saj financiare si me dhe per periudhen e mbyllur me 31 dhjetor 2017.

Me poshtë tabela e vjetërsisë se llogarive te arketueshme:

	Vlera kontabël neto	3 muaj ose më pak	3-12 muaj	1-5 vite
Llogari te arketueshme me 31 dhjetor 2017	93,320,938	93,320,938	-	-
Llogari te arketueshme me 31 dhjetor 2016	13,612,147	13,612,147	-	-

c) Risku i likuiditetit

Shoqeria nuk ka një eksposizim te rendesishem ndaj rrezikut te likuiditetit. Detyrimet financiare perbehën vetem nga llogarite e pagueshme tregtare gjate rrjetës normale te biznesit dhe llogari te pagueshme nga institucionet financiare.

26. ANGAZHIME DHE NGJARJE TË KUSHTËZUARA

Shoqëria nuk është subjekt i ndonjë çështje ligjore të ndërmarrë nga palë të treta kundër saj më 31 dhjetor 2017 që mund të sjellë humbje apo flukse të rëndësishme dalëse në të ardhmen.

Eco Tirana Sh.A.

Shenime shpjeguese të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

27. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT

Me date 13 shkurt 2018, shoqëria Meg Albania Shpk shiti kuotat e saj (49%) Shoqërisë Integrated Energy BV SPV Sh.p.k.

Nuk kanë ndodhur ngjarje të tjera të mëtejshme pas datës së raportimit që të kërkojnë ndryshime apo rregullime të mëtejshme të pasqyrave financiare..

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touche Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee ("DTTL"), its network of member firms, and their related entities. DTTL and each of its member firms are legally separate and independent entities. DTTL (also referred to as "Deloitte Global") does not provide services to clients. Please see www.deloitte.com/al/about to learn more about our global network of member firms.

Deloitte provides audit, consulting, legal, financial advisory, risk advisory, tax and related services to public and private clients spanning multiple industries. Through a globally connected network of member firms in more than 150 countries and territories bringing world-class capabilities, insights, and high-quality service to address clients' most complex business challenges. To learn more about how Deloitte's approximately 263,900 professionals make an impact that matters, please connect with us on Facebook, LinkedIn, or Twitter.

###

Deloitte i referohet një ose me shumë firmave të Deloitte Touche Tohmatsu Limited, një kompani private e limituar nga garancitë, secila prej tyre është entitet ligjor i ndarë dhe i pavarur. Ju lutem shikoni www.deloitte.com/al/about për një përshkrim më të hollësishëm të strukturës ligjore të DTTL dhe të firmave të saj anëtare.

Deloitte ofron shërbime në auditim, konsulencë, shërbime ligjore, shërbime të konsulencës finaciare, shërbime mbi riskun, taksë dhe shërbime lidhur me to, për klientë publikë dhe privatë një të gjitha industritë që ato operojnë. Me një rrjet global firmash anëtare në më shumë se 150 vende, Deloitte sjell ekspertizë me nivel ndërkombëtar dhe shërbime me cilësi të lartë për klientët e saj, duke i dhënë bizneseve njohuritë që iu nevojiten për të adresuar sfidat më komplekse që ata hasin. Për të mësuar më shumë rreth impaktit për të cilin angazhohen rreth 263 900 profesionistë të Deloitte, ju lutem vizitonи faqet tona në Facebook, LinkedIn, ose Twitter.

Str.Rr.Elbasanit,
Ballati poshtë Fakultetit Gjeologji – Miniera,
Tirana, Albania

www.deloitte.com/al

© 2018 Deloitte Audit Albania Sh.P.K